



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë , më 10.07.2023

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 07.07.2023.

Znj. _____

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 07.07.2023 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1- A ka pasur Bashkia juaj buxhet vjetor te planifikuar per rinine (grup moshen 15-29 vjec) per periudhen janar -dhjetor 2022? Nese po, sa perqind te shurnes totale te buxhetit zene keto zera? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse nuk ka nje planifikim te tille?

Po për rininë kemi parashikuar dhe propozuar në Këshillin Bashkiak buxhet dedikuar rinisë për aktivitetet që të rinjt duan dhe kanë nevojë të zhvillojnë e cila është bërë në formën e një seance dëgjimore prezantimi i planeve të aktiviteve.

2-A ka te punesuar prane Bashkise suaj individe te moshes 18-29 vjec (perfshire drejtuesit)? Sa prej tyre jane femra dhe sa meshkuj?

Po ka të punësuar nga kjo grup moshë; janë 11 femra dhe 21 meshkuj.

3- Sa eshte perqindja e te rinjve (18-29 vjec) te punesuar krahasuar me numrin total te administrates?

Përqindja është 14.29%.

4- A ka Bashkia juaj politika rinore te zhvillura specifikiisht per grup moshen 15-29 vjec? Nese po a mund te na dergoni nje kopje te tyre? Nese jo, ju lutem a mund te na tregoni disa nga arsyet perse

nuk ka te zhvilluar nje politike te tille?

Po prane Bashkisë Himarë është ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë më nr.375 Këshilli Vendor Rinor me nr.375, datë 30.12.2022, që merret me çështjet dhe problematikat e të rinjve.

5- A keni ne institucionin tuaj struktura pergjegjese per politikat rinore? Nese po, cilat jane ato (psh. drejtori, sektore, specialiste, struktura perfaqesimi rinor politike etj) dhe prej sa kohesh jane funksionale?

Personi përgjegjës për çështjet rinore është Znj. Marjeta Sina (specialisti i arsimit dhe rinisë) ,që është pjesë e drejtorisë së burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse, strukturat rinore janë në funksion prej datës 30.12.2022.

6- A ka struktura rinore te ngritura ne Bashkine tuaj dedikuar grupmoshes se te rinjve 15-29 vjec (qendra/zyra rinore, keshilla rinore, parlament rinor, struktura konsultative rinore, etj.) per periudhen janar - dhjetor 2022. Nese po, cilat jane ato?

Në Bashkinë Himarë funksionon Këshilli Vendor Rinor, për shkak të numrit të vogël të të rinjve nuk ka organizata rinore vullnetare të rinjsh.

7- Me ke keni bashkepunuar per ngritjen e strukturave te tilla (organizata rinore, grupe te rinjsh, individe, etj)?

Për krijimin e Këshillit Vendor Rinor kemi marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga Agjencia Kombëtare e Rinisë dhe sipas manualit të krijuar nga AKR-ja.

8- A keni pasur ju forma te tjera bashkepunimit (me grupe te rinjsh, organizata rinore, etj) per zhvillimin e aktiviteteve me fokus rinine? Nese po ku kane konsistuar ato?

Po kemi pasur disa aktivitete, me në fokus të rinjtë, kemi bërë anketim me nxënësit e gjimnazeve të gjithë territorit të bashkisë mbi përdorimin dhe varësin e të rinjve në ditët e sotme nga paisjet elektronike specifiksit nga telefoni.

Ka pasur bashkëpunim me organizatën “Zëri të Rinjve”, “UNITED NATIONAL ALBANIA” DHE “YOUTH “ për aktivitet argetues dhe informues me të rinjtë.

Gjithashtu kemi pasur dhe aktivitetin me të gjithë Këshillat Vendor Rinor të Shqipërisë të zhvilluar nga Ministria e Shtetit dhe Fëmijeve, për vlersimin e Strategjisë Kombëtae të Rinisë, me moton “Rinia Vleron”.

9- Sa eshte me perafersi pjesemarrja e te rinjve ne konsultimet publike te zhvilluara nga bashkia? Cilat jane disa nga mjetet apo mekanizmat qe perdor bashkia ne perfshirjen e te rinjve ne te tilla procese?

Pjesmarrja e te rinjve ka qënë mbi 20 persona, mekanizmi i përdorur kryesisht është argëtim dhe socializmi me njeri-tjetrin.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!